



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 30 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 31/ 01 / 2025

VENDIM

Nr.04, datë 31 /01/2025

PËR

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË NJËSITË E DREJTIMIT TEKNIK PËR SIGURINË, KONTROLLIN DHE MONITORIMIN E DIGAVE TË MËDHA GJATË SHFRYTEZIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË TYRE

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 31. 01.2024 mori në shqyrtim problematikat në lidhje me strukturat përbërëse që duhet të funksionojnë pranë Institucioneve, shoqërive private, ndërmarrjeve shtetërore, koncesionareve, bordeve të kullimit dhe bashkive që administrojnë dhe shfrytëzojne digat e mëdha.

Gjatë vitit 2024, përmes Raporteve të dorëzuara nga shfrytëzuesit e digave është konstatuar se në **shumë diga të mëdha mungojnë ekipet apo njësitë e drejtimit teknik në shumë prej shfrytëzuesve të digave që janë përgjegjës për kontrollin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha**. Shumë shfrytëzues të digave kanë caktuar persona që nuk janë inxhinierë dhe që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në legjisacionin e mësipërm. Në shumë raste të tjera, kontrolli, mirëmbajtja dhe monitorimi i digës kryhet nga një person i vetëm i cili nuk plotëson as kërkesat minimale për të kryer këtë funksion.

Bazuar në nenin 5 të VKM së mësipërme, përcaktohet qartë që në cdo Ministri dhe Institucion që administron diga duhet të funksionoj grupi i sigurisë së digave për përbërje inxhinierë hidroteknike dhe inxhinierë të specialitetave të tjera të licencuar nga MIE. Aktualisht, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë apo në strukturat në varësi të saj që administrojnë digat për prodhim Hidroenergjie nuk funksionon një grup i tille. Njëkohësisht, në pikën 2 të Nenit 5 dhe në nenin 29 të VKM së mësipërme kërkohet që pranë cdo shfrytëzuesi të digave të mëdha, duke përfshirë ndermarrjet shtetërore, shoqërite private shpk, koncessionaret, bordet e kullimi, bashkite qe admnistrojnë dhe shfrytëzojnë digat e mëdha duhet të funksionojnë njësitë e drejtimit teknik me përbërje inxhinierë të specialitetit hidroteknik dhe të specialistetave të tjera të licencuar nga MIE sipas kritereve të përcaktuara nga KKDM ,

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm KKDM,

VENDOSI:

- 1- Ti kërkohet shfrytëzuesve të digave të mëdha që përdoren për prodhim hidroenergjie dhe digave përfurnizim me ujë që janë me rrisk të lartë për njerëzit në zonat e banuara poshtë tyre, të kenë në funksion për një digë ose grup digash të mëdha, njësitë e drejtimit teknik me përbërje prej të pakten 3 Inxhinierë me eksperience pune prej jo më pak se 5 vjet në fushën e inxhinierisë civile. Kjo njësi duhet të funksionoj sipas kërkesave të legjisacionit në fuqi dhe të ketë në përbërje të paktën një Inxhinier hidroteknik, një inxhinier ndërtimi ose inxhinier gjeolog ose inxhinier gjeodet ose inxhinier si dhe një inxhinier civil ose teknik ndërtimi me eksperience mbi 5 vjet në fushën e kontrollit dhe monitorimit të objekteve ndërtimore. Një nga këta inxhinierë duhet të jetë i pajisur me licence personale për projektimin ose supervizimin e punimeve të ndërtimit dhe të digave. Detyrat e antarëve të kësaj njësie duhet të janë të përcaktuara në Rregulloren e Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha të miratuar nga KKDM sipas nenit 29 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 2- Ti kërkohet shfrytëzuesve të digave që përdoren për ujitje, bashkive dhe bordeve të kullimit që administrojnë dhe shfrytëzojnë këto diga** të kenë në funksion për një digë ose grup digash të mëdha, njësinë e drejtimit teknik me të paktën tre punonjës ku njeri prej tyre të jetë Inxhinier në sektorin e ndërtimit me eksperience pune prej të paktën 5 vjet në fushën e inxhinierisë civile. Kjo njësi duhet të funksionoj sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Një nga antarët e njësisë teknike duhet të jetë i pajisur me licence personale për projektimin ose supervizimin e punimeve të ndërtimit dhe të digave. Detyrat e antarëve të kësaj njësie duhet të jenë të përcaktuara në Rregulloren e shfrytëzimit, mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha të miratuar nga KKDM sipas nenit 29 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004.
- 3- Ti kërkohet Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë të marrë masa e duhura për ngritjen dhe funksionimin pranë ose Institucioneve të varësise, të Grupit të Sigurisë së Digave të mëdha që përdoren për prodhim hidroenergjie dhe përfurnizimin me ujë sipas kërkesave të Nenit 5 të VKM së lartëpërmendur.** Ky grup duhet të ketë në përberje inxhinierë hidroteknike dhe të specialiteteve të tjera dhe të ushtroj kontolle sipas një plani vjetor dhe në përputhje me legjislacionin e përmendur me sipër. Brenda muajit Mars të cdo viti, ky grup duhet të preqatit një raport vjetor për gjëndjen dhe monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha dhe të informojë MIE dhe KKDM për rezultatet e kontrolleve të kryera si dhe përgjendjen, monitorimin dhe sigurinë e këtyre digave dhe të strukturave hidraulike të tyre sipas kërkesave të neneve përkatëse të përmendura më sipër.
- 4- Ti kërkohet të gjithë shfrytëzuesve të digave të paraqesin një informacion** në Raportin Vjetor të gjendjes, kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së digave për vitin 2024 që do të dorëzojnë pranë KKDM brenda muajit Mars 2025, në lidhje me përberjen e ekipeve të kontrollit dhe shfrytëzimit dhe sigurisë së digave, kualifikimin dhe eksperiencën e antarëve të ketyre ekipeve si dhe detyrat e përcaktuara në Rregulloret përkatëse të këruara në legjislacionin në fuqi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të keëruara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI